

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “G-OIL BERAT” sh.p.k.

Sot, me date 06 Janar 2025, une i neneshkruari:

- Z. Gazment Zyka, Shtetas Shqiptar, lindur ne Berat, me 08.08.1972 me atesi Z. Baftjar, banues ne Poshnje, Berat mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer H20808130H, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) kemi vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “G-OIL BERAT” sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte “G-OIL BERAT” sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: “Rruga Santa Lucia, Godine tre kateshe, Ne zonen kadastrale nr. 8502, me nr. Pasurie 14/74 Berat”.

Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

- Tregti me pakice dhe shumice karburantesh;
- Tregti me pakice dhe shumice gaz te lengshem GLN;
- Tregti me pakice dhe shumice vajra lubrifikantesh;
- Tregti me pakice dhe shumice pjesë këmbimi për makina;
- Bar - kafe.

Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke dhe i ndare ne 1 pjese (kuota) me vlere nomiale 100 000 (njqind mije) leke.

Kapitali zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise si me poshte:

-Z. Gazment Zyka, i cili zoteron 1 kuote te Shoqerise ose 100 000 (njqind mije) leke qe perfaqeson 100 % te kapitalit te Shoqerise.

Ortaket e Shoqerise mund te vendosin te rrisin kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Detyrimet e ortakeve te shoqerise kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre.

Neni 6

Shoqeria vepron nen rregjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.



Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

-Asambleja e Pergjithshme;

-Administratori;

Kompetencat e Asmblese se Pergjithshme si dhe te administratorit te Shoqerise jane te parashkruara ne Statutin e Shoqerise.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 8

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojte rregullat ne fuqi te punesimi dhe te punesuarit jane te detyruar qe ta respektojne Statutin e kesaj Shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe shkaktojne kesaj Shoqerie me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per ekspertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Pergjithshme cakton edhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 11


Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit. Perjashtim, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Per sa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar).

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "G-OIL BERAT" sh.p.k.


Emer Mbiemer Nenshkrimi

